**REPUBLIKA E KOSOVËS**
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS**
OSNOVNI SUD MITROVICA – BASIC COURT OF MITROVICA

---

**C.nr.555/2014**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË,** (e vendosur ne objektin e Degës së Kësaj Gjykate në Vushtrri), si kontestimore e përbërë nga gjyqtari individual Faton Ademi, në çështjen juridike të paditësit: nga kundër të paditurit nga baza e kontestit: Kthim i Huase, në seancën e datës: 15.06.2015 konform nenit 148 të LPK-së bjen këtë:

## A K T GJ Y K I M
**- në bazë të pohimit -**

1. **APROVOHET** në tërësi padia dhe kërkesëpadia e paditësit , kundër te paditurit si e Bazuar dhe

2. **OBLIGOHET** i padituri qe ne emër te borxhit t'ia paguaj paditësit shumen prej 1.500 Euro brenda afatit 30 ditor nga dita e pranimit nën kërcënimin e përmbarimit te detyrueshëm.

3. **OBLIGOHET** i padituri qe ne emër te taksës për padi t'ia paguaj paditësit shumen prej 20 euro si dhe gjykatës ne emër te taksës për vendim po ashtu shumen prej 20 Euro te gjitha këto ne afat 30 ditor.

**A r s y e t i m**

Paditësja me datë: 02.10.2014 ka parashtruar në gjykatë padi kundër të paditurës.

Gjykata ka mbajtur seancën me datë: 15.06.2015. Në këtë seancë pala paditëse deklaroi se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë si dhe propozimeve të cekura në padi për dëgjimin e dëshmitarëve: dhe .

I padituri në seancë deklaroi se e pranon në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë, nuk ka se çfar të shtoi dhe konsideroi se nuk është e nevojshme të dëgjohen dëshmitarët.

Gjykata vlerësoi se pohimi i kërkesëpadisë nuk është në kundërshtim me nenin 3.3 të LPK-së, dhe pa shqyrtim të mëtejmë në procesverbal në prezencën e palëve ndërgjyqëse mori aktgjykim në bazë të pohimit.

Andaj duke u bazuar në nenit 148 të LPK-së gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICE,**
**C.nr. 555/2014 Me dt. 15.06.2015.**

**GJYQTARI,**
**Faton Ademi**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka te drejtë ankese në afat 15 ditor nga dita e pranimit të të njëjtit, Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit nëpërmjet kësaj gjykate.

e ekspeduar në
dt. 30.06.15

21.07.2015